



PROCESVERBAL I/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.01.2024
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2022 të Komunës së Suharekës;**
- 6. Informatë për aktivitetet e KKS-së;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim.

**5 për, 2 apstenime
Miratohet Pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - kur të vijnë vendimet për shfuqizim, të paktën me pas edhe ne arsyetimin se pse e ka kthyer ministria. Nëse e ke ti si kryesues edhe ne është dasht ta kemi këtë sqarim.

Kryesuesi - kanë kërku me vazhdu prap me të vjetrën por raportin që na ka ardhë do t'ua përcjellim.

Dardan Berisha - edhe unë dua ta kem arsyetimin e ministrisë se ku janë bazu ata që ne kemi gabu.

Urim Suka - shqetësimin që e ngriti Liridoni, e kemi thënë vazhdimisht. Ndryshe është kur e lexojmë në atë arsyetim dhe ndryshe është kur ju e interpretoni sepse shpeshherë po e interpretoni qysh po doni dhe për me i arsyetu gabimet që po i bëni në vendimet që po i merrni. Te ky vendim, e kemi thënë edhe këtu, e kemi thënë edhe në Asamble që është një vendim i përgatitur keq dhe nuk keni ndëgjju për vërejtjet që i kemi thënë ne. Gati çdo takim po vje nga një vendim për shfuqizim. Dua të jetë vërejtja e fundit që e japim sepse nuk ka kuptim me ardhë një vendim për shfuqizim dhe neve mos me na ardhë arsyetimi.

Armend Krasniqi - çështja e ndërrimit të emrave në komunën e Suharekës është një çështje e komplikuar. Nuk e di arsyen se pse e ka kthyer ministria. Me një vendim të ministrisë të 2010-tës nuk e kemi gjet arsyeshmërinë me zbatu. Duke e pa që ka mungesë ai vendim i atëhershëm ne e kemi marrë një iniciativë për me gjet një zgjidhje dhe e kemi përgatit lëndën në formën që kemi mendu që është e mirë. Faktikisht edhe zyra e Kryetarit me juristat e vet që i ka, duhet me këqyr dhe me gjet se ku është problematika që mos me e kthyer atë vendim. Ndoshta nuk është bashkëpunimi në nivel të duhur por duhet të rritet bashkëpunimi sepse po na kthejnë disa vendime. Kjo çështje duhet të rregullohet sepse është një

barrë e rëndë për Komunën dhe nuk po mund të zhvillohen procedurat të çdo iniciative që e merr komuna. Do ta shohim arsyetimin dhe do ta dërgojmë prap.

Urim Suka - unë po e kërkoj arsyetimin dhe nëse na sqaroni do të ishte mirë.

Kryesuesi - unë e dhashë sqarimin se çka kanë shkru ata.

Urim Suka - drejtori tha: ne kemi marrë iniciativë. Ne e kemi mbështet këtë iniciativë por e kemi thënë që është keq e përgatitur.

Armend Krasniqi - nëse këta e kanë pa që është e papërgatitur mirë ,unë jam i hapur dhe është dasht të vijnë te unë në zyrë dhe të më thonin që e kam gabim por përkundrazi e kanë mbështet.

Urim Suka - unë nuk jam jurist dhe nuk po mendoj që duhet komplet me ta përgatit vendimin. Unë të kam thënë që është keq e përgatitur, është edhe procesi ku është e shkruar. Përveq që nuk na ka ardhë neve ky arsyetim, as ti si drejtor që e ke sponzorizu nuk e ke arsyetimin. Si të ka ardhë si pikë e rendit të ditës edhe ti me pas qenë më i përgjegjshëm e kishe kërkuar arsyetimin dhe sot kishe ardhë më i përgatitur.

Armend Krasniqi - Urimi po e politizon.

Avni Bytyqi - siq e dini tri vendime janë kthyer nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedis dhe jo vetëm komuna jonë por të gjitha Komunat kanë problem me MMPHI. Ministria e Planifikimit Hapësinor e ka kthyer për arsye se nuk ka bazë ligjore.

Liridon Fandaj - nuk është bash kështu sepse kur po ju konvenon për ndonjë vendim tjetër, nuk e sillni për shfuqizim por provoni edhe tre-katër herë të jepni sqarime. Juve iu ka kthyer edhe për Ballkanin MAPL.

Avni Bytyqi - unë thashë me ministri të infrastrukturës kemi telashe dhe me asnjë ministri tjetër.

Liridon Fandaj - nëse ti me MAPL pe gjen një rrugë tjetër dhe po intervenon në Ministri të Ekonomisë dhe Financave edhe këtë është dashtë me sqaru. Nëse drejtori e jep një propozim, zyra ligjore është ajo që i thotë që kjo s'është ligjore.

Avni Bytyqi - i kemi thënë ne në zyre të Kryetarit dhe e din drejtori mirë qe kjo qështje nuk shkon përmes Kuvendit po kjo çështje rregullohet me vendimet e Sekretarit permanent te Ministrisë.

Kryesuesi - e kemi pas bisedë dhe ne. Iu kemi drejtu DKA-së me i gjet disa vendime të vjetra dhe ata nuk janë marrë me këtë çështje.

Armend Krasniqi - i kemi gjet vendimet bashkërisht me DKA-në por vendimet që i ka gjet drejtorja nuk ka asnjë bazë ligjore për me ekzekutua atë vendim që e ka marrë ministria. Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - këtu thuhet buxheti fillestar 21 milion dhe buxheti i alokuar 22 milion. Kërkoj sqarime .

Labinot Halitjaha - janë 917.000 bartje.

Urim Suka - por edhe nëse është 900.000 prap e tejkalon këtë.

Labinot Halitjaha - janë edhe të performancës dhe bashkëngjiten edhe ato dhe vjen vlera në 22 milion.

Urim Suka - ne për këto llogari financiare kemi fol në vazhdimësi dhe për mënyrën e shpenzimit të buxhetit kemi fol dhe kemi dhënë kritika vazhdimisht. Ajo që më shqetëson është se nga viti në vit gjërat nuk kanë shku duke u përmirësuar në Komunën tonë por kanë shku duke degraduar. P.sh. te pjesa e mjeteve të pa shpenzuara ky vit është një rekord i mjeteve të shpenzuara ku janë rreth 2 milion euro duke e llogarit edhe suficitin dhe mjetet që kanë me u bartë, mbi bazën e kësaj çka ju keni shkru në raport. Sipas disa çështjeve që unë i kam pa, ka edhe buxhet që është shpenzuar e që në teren punët nuk janë kry. Tabela e vitit të kaluar me këtë tabelë ka ndryshime, nuk është uniforme. P.sh. çka. nënkupton buxheti free balance.

Labinot Halitjaha - janë mjete të lira të cilat kanë mbet prej projekteve.

Urim Suka - kërkoj sqarim më të qartë se cili është suficiti tek projektet.

Labinot Halitjaha - si buxhet total është 22.677.570, është vlera e grandit qeveritar dhe vlera e të hyrave vetanake të planifikuara 2.193.000 dhe 917.000 janë të bartura nga viti paraprak por buxheti ndryshon sepse ne i kemi rrit të hyrat këtë vit rreth 30 % më shumë. Pra duhet ta paramendojmë se shkojnë suficit sepse ato janë mbledh më shumë. Janë 260.000 € janë suficit të grandit qeveritar ku kanë tepër prej projekteve. Te fondi burimor(22) janë 917.179€ dhe janë shpenzuar afërsisht 631.000€. Nuk janë shpenzuar

në total sepse ju e dini që ka ardhë tri herë në Asamble dhe u kthye mbrapsht për shkaqe procedurale dhe ndryshime të rregulloreve të cilat janë ndryshu në qeveri. 497.000 janë të hyra vetanake të viti 2023 të muajit nëntor dhe dhjetor të cilat nuk ka pas shancë të shpenzohen. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - te pasqyra përfundimtare ku ju e keni shkruar, shkruan :shuma prej 451,937.25 na paraqitet si suficit. A është 451,000.00 suficiti apo është 265,000.00?

Labinot Halitjaha - 268.000 duhet me qenë suficiti.

Liridon Fandaj - te pasqyra përfundimtare shifrat nuk përputhen me ato që janë në tabelë.

Kryesuesi - për këtë raport sqarime do të jep ZKF në Asamble.

Urim Suka - sa janë suficit te mallra dhe shërbime, sa janë suficit prej komunalisë dhe sa janë suficit prej investimeve kapitale?

Labinot Halitjaha - afërsisht 268.000 janë investime kapitale, mallra dhe shërbime janë afërsisht 100.000 dhe subvencione 80.000. Kanë tepru secilën vijë buxhetore nga pak.

Urim Suka - në këtë raport që e keni dorëzuar a figurojnë se sa janë suficit mallra dhe shërbimet, sa janë investime kapitale, sa janë komunalitë dhe a janë në tabela?

Labinot Halitjaha - duhet me qenë dhe nëse nuk janë do ti dërgoj me email.

Liridon Fandaj - te pasqyra përfundimtare nëse ne i themi edhe drejtoritë veq e veq atëherë te pasqyra financiare këto shifra nuk përputhen ose i është përzi formula në excel. Këtë raport duhet me përmirësu dhe nuk kisha thënë me dërgu kështu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 4**

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2022 të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ju thatë që Komuna jonë në të gjitha indikatorët e vlerësimeve është e para gjithmonë. Për dallim prej juve unë e kam lexu këtë raport dhe ju e keni marrë vetëm ku ju është dasht juve. Urim Suka lexon disa fusha të raportit të performancës dhe një pjesë të raportit të performancës te arsimit ku thotë: në përgjithësi në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota dhe kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relativisht të saktësisë. Pra nuk është ashtu se si e kanë dhënë ata për shkak se përgjigjet nuk kanë qenë të plota. Te pjesa që the që ne kemi dalë gjithmonë të parët, unë ti numërova. Prej 90 treguesve 13 ti numërova që ke dal ma nalt se 10. Gjendja nuk është për me u lavdu.

Rinor Zyrapi - si rezultat i performancës shumë të mirë në Kosovë, jemi në pesëshen e parë për grand në nivel të Kosovës.

Liridon Fandaj - mua nuk më intereson a i merr 5 milion apo 10 milion por mua më intereson në teren çka ka.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Informatë për aktivitetet e KKSB-së;

Kryesuesi - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj